

REPubLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 4538 Prot.

Laç, me 01.11.2021

**V E N D I M**

**mbi**

**Njoftimin me shpallje publike per palen debitore**

Ne Lac, sot me date 01.11.2021

Une, Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqesor prane Zyres Permbarimore Kurbin , pasi studiova aktet proceduriale te ceshtjes permbarimore Nr. 102/CP141020210001 rregj. te vitit 2021 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit nr. 38 regjistri te dates 20.04.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Lushnje,

**KONSTATOVA:**

Se ne date 14.10.2021 eshte depozituar nepermjet sherbimit postar (RR632416482AA) te Postes Shqiptare sh.a prane Zyres se Permbarimit Kurbin, kerkesa e kreditorit Rrapi Fetahu , per venie ne ekzekutim te detyrueshem se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqesor ) nr. 224(64-2017-541) te dt 20.04.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Lushnje qe ka marre forme te prere pa u ankimuar me date 05.06.2017, me pale dhe objekt si me poshte:

-Kreditor: Rrapi Qani Fetahu

-Debitor: Etmira Vesel Zyba e dtj.07.10.1981, me nid:F16007010R, me banim ne Laç.

-Me Objekt: Detyrimin e te paditues Etmira Fetahu, te paguaje per femijen e saj te mitur nje detyrim ushqimor , ne masen 5000 (pesemije) leke. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes se padise , nga data 07.02.2017.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitorja Etmira Vesel Zyba (Fetahu) nuk merr dijene per aktet permbarimore nepermjet sherbimit postar pasi rezulton i larguar jashte sipas shenimeve te punonjesit te Postes Shqiptare ndersa sipas shkreses zyrtare te Z.GJ.CIVILE Lac eshte banore e kesaj zyre. Ne keto kushte si rezultat i kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile lind e nevojshme te procedohet me njoftimin me shpallje publike te debitorit lidhur me detyrimin qe ajo ka ndaj pales kreditore Rrapi Qani Fetahu per detyrimin per ushqim te palikujduar ndaj femijes se mitur.

Sa me sipër ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor", i ndryshuar

**V E N D O S A**

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njezet) ditor (duke marre parasysh edhe komunikimin postar) nga data 01/11/2021 - 20/11/2021 te debitores Etmira Vesel Zyba e dtj.07.10.1981, me Nid:F16007010R, me banim ne Laç .

2-Ky vendim perpilohet ne disa kopje, ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore, nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Bashkise Kurbin/Njesise perberese , nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore Etmira Vesel Zyba e dtj.07.10.1981, me nid:F16007010R, me banim ne Laç dhe me kalimin e ketij afati konsiderohet pala e njoftuar.

4-Pala debitore Etmira Vesel Zyba e dtj.07.10.1981, me nid:F16007010R, me banim ne Laç, duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4, Lac ne katin e pare ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'ju vene ne dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 01.11.2021.

**PERMBARUES GJYQESOR  
MIKEDA CENAJ**

